

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-142/2015

**Prishtinë
17 Janar 2018**

Në çështjen juridike të:

S. S. T.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje “Vendimi i KKPK-së”) Nr.KPCC/D/R/223/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA25346), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 Janar 2018, mori këtë vendim:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. S. T. e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, të datës 27 nëntor 2013, lidhur me Kërkesën KPA25346.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013, i datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA25346.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 30 mars 2007, S. S. T. (në tekstin e mëtejme "Pala ankuese") paraqiti një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: "AKP") duke kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore të banesës me sipërfaqe prej 54.21 m², Rruga Vidovdanska, 38/5 në Prizren (në tekstin e mëtejme "prona e kërkuar"). Ai pretendon se i është ndarë objekti nga Komuna e Prizrenit dhe se ai e ka humbur posedimin mbi të më 15 qershor 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese i dorëzoi këto dokumente në AKP:
 - Një kopje të Vendimit për ndarjen e banesës për shfrytëzim të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, në bazë të cilit prona e kërkuar i ishte ndarë palës ankuese dhe familjes së tij.
 - Një kopje të kontratës për shfrytëzimin e banesës me numrin 236-10/98 të lidhur më 15 tetor 1998 ndërmjet Ndërmarrjes Publike Banesore dhe S.T, në bazë të së cilës prona e kërkuar i është dhënë palës ankuese për shfrytëzim për kohë të pacaktuar.
 - Një kopje të letërnjoftimit të palës ankuese të lëshuar nga organet kompetente më 16 mars 2006.
3. Një përpjekje për njoftimin e kërkesës u bë më 18 shtator 2008. Prona e kërkuar dukej se ishte një banesë e zbrazët dhe jo e uzurpuar.
4. Siç mund të lexohet nga Raporti i Konsoliduar i Verifikimit të datës 11 shkurt 2011, si Kontrata ashtu dhe Vendimi për Ndarje u verifikuan negativisht.
5. Më 27 nëntor 2013, KKPK-ja me Vendimin KPCC/D/R/223/2013 e refuzoi kërkesën e palës ankuese me arsyetimin në paragrafin 32 se pala ankuese nuk kishte paraqitur asnjë provë, ose ndonjë provë që do të mund të verifikohej nga Sekretaria Ekzekutive, se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore i gëzon të gjitha të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar ndonjë provë të tillë sipas detyrës zyrtare. Prandaj, sipas mendimit të Komisionit, kërkesa u desh të refuzohet.
6. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës ankuese në datë të paspecifikuar. Avokati i autorizuar parashtrroi ankesë në emër të palës ankuese më 25 nëntor 2015.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese kërkoi që Vendimi i KKPK-së të hidhet poshtë si i pabazuar dhe të aprovohet ankesa e tij duke deklaruar se ai ka qenë shfrytëzuesi legjitim i pronës së kërkuar. Ai shpjegoi se "banesa i ishte ndarë atij për shfrytëzim në vitin 1998 dhe që atëherë ai vazhdon ta përdor atë, edhe sot, gjashtëmbëdhjetë vite më pas". Kopja e Kontratës dhe e Vendimit i janë bashkëngjitur ankesës.

Arsyetimi ligjor:

8. Gjykata Supreme e shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006 (në tekstin e mëtejme "LPK") dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese arriti në përfundimin se ankesa është e pabazuar.
9. Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, me kusht që paraqitësi i kërkesës "e dëshmon" të drejtën e tij të shfrytëzimit të pronës mbi pronën private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe gjithashtu dëshmon se ai/ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 ose për shkak të rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
10. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të paraqet prova në mbështetje të kërkesës së tij për ta vërtetuar të drejtën e tij të pronësisë ose të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën e paluajtshme private.
11. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë kur e refuzoi kërkesën, duke argumentuar se pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë se ai ka gëzuar të drejta pronësore mbi pronën e kërkuar. Asnjëra nga dy dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk kanë mundur të verifikohen pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive, që do të thotë se kërkesa nuk ishte mbështetur fare me ndonjë provë për të dëshmuar titullarin e pronës së kërkuar.
12. KKPK-ja e bazoi vendimin e vet në faktin se pala ankuese është kontaktuar dhe i janë kërkuar prova shtesë, megjithatë ai nuk ka paraqitur asnjë provë që ka mundur të verifikohet nga AKP-ja, dhe Sekretaria Ekzekutive sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur ndonjë dëshmi tjetër.
13. Dokumentet që janë vërtetuar negativisht nuk përbëjnë dëshmi të së drejtës së pretenduar të pronësisë. Pasi që nuk është gjetur ndonjë provë në regjistrat publik se prona është e regjistruar në emër të palës ankuese, pretendimet e tij nuk mund të çonin në pranimin e kërkesës.
14. Duhet të theksohet këtu se pala ankuese pretendoi se "banesa i ishte ndarë atij për shfrytëzim në vitin 1998 dhe që atëherë që ai ka vazhduar ta shfrytëzojë, edhe sot, gjashtëmbëdhjetë vjet më pas". Nëse është kështu, kërkesa e palës ankuese po ashtu duhej të hidhej poshtë edhe për shkak të kushtit të nenit 3.1 të Ligjit për shkak të pamundësisë së ushtrimit të të drejtave pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Kërkesa e një personi që deklaroi se ai/ajo ende po e shfrytëzon pronën e paluajtshme është e papranueshme për shkak të mungesës së interesit ligjor në ndjekjen e kërkesës, por edhe për shkak të mungesës së juridiksionit të AKP-së.
15. Duke u bazuar në arsyet e sipërpërmendura, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar pas një procedure korrekte. Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale ose vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
16. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, në pajtim me nenin 13.3 (c) të Ligjit Nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.
17. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar ndonjë mjet juridik që mund të jetë në dispozicion para gjykatës vendore.

Këshillë ligjore

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegji

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues detyre i referentit të EULEX-it